

UDC 341.231.14

Muhamed Jashari, MA<sup>524</sup>

**KONCEPTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT, SOVRANITETIT  
SHTETËROR DHE PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR**

**КОНЦЕПТОТ НА ЧОВЕКОВИТЕ ПРАВА, ДРЖАВНИОТ  
СУВЕРЕНИТЕТ И ОДГОВОРНОСТА ЗА ОДБРАНА**

**THE CONCEPT OF HUMAN RIGHTS, STATE SOVEREIGNTY  
AND RESPONSIBILITY TO PROTECT**

---

Abstract

For the human society, respecting the human rights is considered a crucial issue. The future of mankind would be in a chaotic situation without respecting the human rights. Order in international system doubtlessly would be reached through promoting and respecting the basic human rights of the individual. The main goal of human rights is to protect human beings from violence, repression, degradation and cruelty.

After the cold war, in the international “jungle” there appeared new challenges, hence interest and focus for the human rights increased further more. Despite the fact that the issue of human rights is on the agenda of different international organisations, such as United Nations – UN, Organization for Security and co-operation in Europe – OSCE, Council of Europe, Arab League etc, the discussion on human rights in academic couloirs is of course a special

---

<sup>524</sup> MA në Shkencat Politike, Qendra për gjuhë të huaja, kurse përgatitore dhe trajnime – FLUENT. ([muhammed\\_j88@hotmail.com](mailto:muhammed_j88@hotmail.com))

contribution. Although the human rights are treated in different parts of the world, hence these rights are universals.

In the article below there is initially provided a philosophical approach on the concept of human rights, then the role of UN is discussed in promoting and respecting the human rights. In this article there will also be discussed the correlation between state sovereignty and human rights and freedoms, on which of these two principles is more important for the international community.

The doctrine “Responsibility to Protect” is relatively a new doctrine in international politics, which will be subject of discussion as well.

**Key words:** Human rights, international right, international community, globalisation, humanitarian intervention, responsibility to protect

### Abstrakt

Për shoqërinë njerëzore respektimi i të drejtave të njeriut konsiderohet çështje kruciale. Pa respektimin e të drejtave të njeriut e ardhmja e njerëzimit do të ishte në një gjendje kaotike. Rendi, në sistemin ndërkombëtar pa dyshim se do të arrihej përmes promovimit dhe respektimit të të drejtave themelore të individit. Qëllimi i të drejtave të njeriut është që të mbron qeniet njerëzore nga dhuna, represioni, degradimi dhe mizoria.

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë në “*xhunglën*” ndërkombëtare u paraqitën sfida të reja, që këtu interesimi dhe fokusi për të drejtat e njeriut u rrit edhe më shumë. Edhe pse çështja e të drejtave të njeriut gjendet thuhet në agjendën e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si në Organizatën e Kombeve të Bashkuara – OKB, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunimit në Evropë – OSBE, Këshillin e Evropës – KE, Ligën Arabe etj., diskutimi i të drejtave të njeriut në qarqet akademike padyshim se është një kontribut i

veçantë. Me që të drejtat e njeriut trajtohen në regjione të ndryshme të globit, që këtu, si të tilla këto të drejta janë universale.

Në artikullin më poshtëm fillimisht jepet një qasje filozofike e konceptit të të drejtave të njeriut, më pas aty flitet për rolin e OKB-së në promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në këtë artikull po ashtu do të diskutohet korrelacioni i sovranitetit shtetëror me të drejtat dhe liritë e njeriut, për atë se vallë cili nga këto dy parime për bashkësinë ndërkombëtare ka më tepër rëndësi!?

Doktrina “Përgjegjësia për të mbrojtur”, një doktrinë relativisht e re në politikën ndërkombëtare do të jetë po ashtu temë studimi.

**Fjalët kyçe:** Të drejtat e njeriut, sovraniteti, e drejta ndërkombëtare, bashkësia ndërkombëtare, Globalizimi, intervenimi humanitar, përgjegjësia për të mbrojtur.

## HYRJE

Pa dyshim se mbrojtja e drejtave të njeriut përbën një element mjaft të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Për mbrojtjen sa më efikase të të drejtave dhe lirive të njeriut, shtetekombe formuan atë që sot ne e quajmë Organizatë të Kombeve të Bashkuara. Ky mekanizëm ndërkombëtar është institucioni më i lartë në politikën botërore që garanton këto të drejta, madje për këtë shkak inauguroi Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Mund të thuhet se nuk ka sesion në OKB, e që të mos përmenden të drejtat dhe liritë e njeriut.

Vlen të përmendet fakti se parim mjaft i rëndësishëm në të drejtën ndërkombëtare, është “mos ndërhyrja në punë e brendshme të shtetit”.

Kjo çështje është vendosur qartë në kartën e OKB-së. Mirëpo, në të shumtën e rasteve nëpër vende të ndryshme të botës duke u thirrur në emër të së drejtës ndërkombëtare dhe kartës së OKB-së,

pra “mos ndërhyrjes në punë të brendshme të shtetit” u shkelën të drejtat e njeriut.

Në vitin 2005 OKB-ja inauguroi atë që quhet “Responsibility to Protect” apo “Përgjegjësia për të mbrojtur”. Përmes këtij koncepti shteti duhet t’i mbrojë qytetarët e vet nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit. Shtetet që e mbështetën këtë iniciativë u akorduan që komuniteti ndërkombëtar duhet të merr veprime konkrete në rast se ndonjë shtet dështon për t’iu përmbajtur këtij parimi.

## FILOZOFIA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Dinjiteti njerëzor është i vjetër po aq sa edhe historia e njerëzimit. Ajo si e tillë ekzistoi tek të gjithë popujt, kulturat, civilizimet, dhe religjionet. Në filozofinë afrikane shohim se “*Ubuntu*” është një koncept përmes së cilës shprehet humanizmi i qenies njerëzore, si dhe raporti i njeriut me botën.

Pra *rregulli i artë* sipas së cilit njeriu duhet të sillet me të tjerët, ashtu siç dëshiron që edhe të tjerët të sillen me të, ekziston tek të gjitha kulturat.

Projekti ndërkombëtar për “Etikën Globale” nën udhëheqjen e Klaus Kung-ut, zbuloi se të gjitha religjionet e mëdha përmbajnë vlera të përbashkëta të cilat në masë të madhe korrespondojnë me të drejtat e njeriut.

Të drejtat e njeriut përfshinë tërë qeniet njerëzore, qoftë mashkull ose femër, i pasur ose i varfër, i moshuar ose fëmijë, i shëndoshë ose i sëmure, i shkolluar ose i pa shkolluar. (Orend, 2002:15).

Të gjithë këto janë anëtarë të komunitetit njerëzor dhe bëjnë pjesë në atë që quhet “të drejtat të njeriut”.

Teoria klasike e të drejtave natyrore zhvilluar nga filozofi anglez Xhon Loku (*John Locke*) që në shek XVII-të parashihte se çdo qenie njerëzore ka të drejta të caktuara që rrjedhin nga Zoti

ose natyra, e jo nga qeveria apo ligjet e saj, (Freeman, 2011:9), kurse legjitimiteti i qeverisë mbështetet në respektimin e këtyre të drejtave.

Koncepti modern i të drejtave të njeriut është riformulim i kësaj teze dhe i referohet kryesisht raporteve të qeverisë dhe qytetarëve.

Filozofët si Zhan Zh. Ruso, Volter dhe Xhon Stjuart Milli, diskutuan për çështjen e të drejtave të njeriut. Sipas “Etërve themelues”<sup>525</sup> ato të drejta iu ndanë njerëzve në këmbim të lojalitetit të tyre ndaj qeverisë.

Filozofi gjerman Imanuel Kant me qasjen e tij kozmopolite paraqiti të drejta të caktuara për “*qytetarin e botës*”.

Në “Kontratën sociale” të Zhan Zh. Rusosë liria e njeriut zinte vend të rëndësishëm. Ai pohonte se të heqësh dorë nga liria do të thotë të heqësh dorë nga të qenit njeri, të braktisësh të drejtat e njerëzimit, madje edhe detyrat e tij. (Stumpf, 2000:137). Në filozofinë politike liberale, universalizmi sheh individin si njësi sociale tek të cili të drejta të patjetërsueshme janë të drejtat civile dhe ato politike, por edhe e drejta për pronë. (Pollis, Schwab, 2000:10)

Në deklaratën e pavarësisë së SHBA-së, të vitit 1776 të drejtat natyrore përfshinin jetën, lirinë, dhe ndjekjen e lumturisë, kurse të drejtat tjera natyrore janë të mbrojtura në “ligjin për të drejtat”, ku ndër tjerash bëjnë pjesë liria e fjalës, e religjionit, dhe shtypit.

Revolucioni francez, - i cili u iniciua nga deklarata amerikane për pavarësi si dhe proklamimi i ligjit për të drejta - në vitin 1789 shpalli deklaratën franceze për të drejtat e njeriut dhe qytetarit. (Sweet, 2003:20).

Deklarata, të drejtave të njeriut i vendosi në qendër të vëmendjes dhe shpalli se liria, siguria e pronës dhe rezistenca ndaj shtypjes, janë të drejta natyrore të qenies njerëzore.

Paraardhësit e mëhershëm të të drejtave ndërkombëtare të njeriut mund të gjenden në marrëveshjen për lirinë e përkatësisë

<sup>525</sup> “Etërit themelues” konsiderohen politikanët e hershëm amerikan, të cilët participuan në hartimin e Deklaratës Amerikane për Pavarësi.

fetare, përfshirë në marrëveshjen e Uestfalisë - 1648, pastaj në formimin e shoqatës amerikanë kundër skllavërisë - 1833, si dhe konventën ndërkombëtare kundër skllavërisë të vitit 1926.

Mbrojtja e pakicave ishte po ashtu temë debati në konferencën e Versajës në vitin 1919, si dhe në ligën e kombeve.

Nga kjo që u tha më lartë konstatojmë se të drejtat e njeriut në qendër të vëmendjes vendos njeriun. Ai bazohet në një sistem të përbashkët universal të vlerave që i dedikohet shenjtërisë së jetës dhe ofron kornizë për ndërtimin e sistemit të të drejtave të njeriut, që mbrohen me norma dhe standarde ndërkombëtare.

Pra, e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut bazohet në vlerat e përbashkëta të miratuara në Kombet e Bashkuara, të cilët njëherit paraqesin elemente të “etikës globale”. Mirëpo, koncepti i të drejtave universale të njeriut për të gjithë njerëzit u bë i pranueshëm për njerëzit vetëm pas tmerreve të Luftës së Dytë Botërore (LDB-së), pikërisht atëherë kur u miratua edhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut në vitin 1948.

## ROLI I KOMBEVE TË BASHKUARA NË RUATJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Natyrisht se OKB-ja përbën institucionin kryesor në arenën botërore ku synohet të ruhet paqja, liria, të drejtat e njeriut, barazia etj. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore tradicionalisht trajtoheshin si çështje e brendshme, dhe rregullimi i tyre bëhej me ligje, deklaratat dhe kushtetutë.

Me formimin e OKB-së si një institucion që do të ruajë paqen dhe stabilitetin në botë, u krijua një botëkuptim i gjerë, se respektimi i të drejtave të njeriut është esenciale për ruajtjen e rendit ndërkombëtar. (Elezi, 2008:40).

Pas luftës së tmerrshme (LDB) që pa njerëzimi, si dhe kujdesi që në të ardhmen të mos ndodh një skenë e tillë, OKB-ja preokupim qendror kishte promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Tanimë respekti për të drejtat e njeriut dhe dinjiteti njerëzor u bë themel i lirisë, paqes dhe drejtësisë në mbarë globin.

Për këtë qëllim Asambleja e Përgjithshme e KB-së në vitin 1948 miratoi Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Pas viteve të 50-ta janë miratuar edhe një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Që në preambulën e Kartës së OKB-së riafirmohet besimi për të drejtat themelore të njeriut, dinjitetit të njeriut, si dhe barazia ndërmjet meshkujve dhe femrave.

Neni 1 thekson se qëllimet e kësaj Karte janë: “... për të mbështetur dhe forcuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjuhe apo besimi fetar”, ndërsa kapitulli IV i cili flet për kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme në nenin 13-të thuhet: “Asambleja e përgjithshme inicicion procese hetimore dhe jep rekomandime... për të kontribuar në realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij pa dallim race, gjinie, gjuhe apo besimi fetar...”.

Jo vetëm Asambleja e Përgjithshme, por edhe Këshilli ekonomiko-social është organ tjetër i OKB-së i cili merret me veprimtarinë e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ky organ njëkohësisht i bën rekomandime Asamblesë së Përgjithshme për çështjen e të drejtave të njeriut. Pikërisht për këtë, në kreun e X-të, neni 62, thuhet: “... Ai mund të japë rekomandime për të mbështetur respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë...”.

Karta e OKB-së në mënyrë eksplicite nuk ka ndonjë dispozitë që i detyron apo obligon shtetet që të sigurojnë respektimin e plotë dhe efektiv të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, por ekziston një botëkuptim dominues për respektimin e tyre. Ky është obligim moral dhe juridik sa do i papërsosur. (Elezi, 2008:43).

## KORRELACIONI I SOVRANITETIT SHTETËROR ME KONCEPTIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Përderisa për konceptin e të drejtave të njeriut ekzistojnë interpretime të ndryshme në atë se çfarë janë, si duhet të zbatohen dhe çfarë statusi legal duhet t'iu jepen, Karta e OKB-së vë theks të rëndësishëm në një parim tjetër. Ky parim në të shumtën e rasteve gjatë pjesës së dytë të shek. XX-të ishte ndoshta më i rëndësishëm se sa koncepti i të drejtave të njeriut. Fjala është pikërisht për sovranitetin apo mos ndërhyrjen në punë të brendshme të shtetit. Për shekuj me radhë sovraniteti është konsideruar atribut i shtetit. (Krasner, 1983: 53).

Karta e OKB-së përgjegjësinë kryesore për “ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare” ia jep Këshillit të Sigurimit - më poshtë KS - pra organit kryesor të OKB-së.

Në kreun e VII-të të Kartës së OKB-së, përkatësisht në nenin 39 thuhet:

*“Këshilli i Sigurimit është ai, që përcakton, nëse kemi të bëjmë me një kërcënim ose prishje të paqes ose sulm”.*

Se vallë termi “kërcënim i paqes” konsiderohet vetëm sulm i një shteti ndaj një shteti tjetër anëtar të OKB-së, apo edhe krimet të cilët kryen kundër popullatës civile brenda integritetit territorial ose shkeljes së rëndë të të drejtave të njeriut, këto çështje u bënë temë debati në qarqet akademike.

Në vitet e para të Luftës së Ftohtë KS-ja duket se e izoloi veten nga shqetësimi për të drejtat e njeriut. Prandaj, shprehja “*kërcënim për paqen*” më shumë i dha prioritet mos-ndërhyrjes në punë të brendshme të shtetit, se sa parimit të promovimit të të drejtave të njeriut. (Mertus, 2009:98-100).

Një mendësi e tillë brenda disa anëtarëve të KS ekziston edhe sot, *veto*-ja e Ruisë në rastin e krizës siriane është shembull i kësaj.

Përpjekja për të lartësuar të drejtat e njeriut zakonisht kritikohet nga qeveritë që kanë probleme me shkeljen e të drejtave të njeriut, duke i vështruar ato si “ndërhyrje në punë të brendshme”,

gjë që përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Kjo akuzë e vendos ligjin për të drejtat e njeriut në një terren të lëkundshëm. Vetë ideja e të drejtave të njeriut është në kundërshtim me sovranitetin dhe tërësinë tokësore të shteteve. (Goldstein 2001:322).

Që nga traktati i Uestfalisë të viti 1684, prej nga edhe shtetit i jepet sundim i pakontestueshëm brenda kufijve të vet, si dhe ndalimi në ndërhyrjen e çështjeve të brendshme të tij, koncepti i sovranitetit u bë dogma dominuese në politikën ndërkombëtare. (Mirbagheri, 2000).

Atëherë kur forcat e NATO-s intervenuan në Kosovë në vitin 1999, ambasadori kinez në OKB, Shen Guofang në mënyrë të ashpër reagoi kundër këtij veprimi. Ai konsideronte se: *“Respektimi i sovranitetit dhe mos ndërhyrjes në punë të brendshme të shtetit janë principe bazike të kartës së OKB-së”*.

Pa dyshim se koncepti i mos ndërhyrjes në punë të brendshme të shtetit mbetet ndër themelet e rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare. Ajo është pjesë e të drejtës ndërkombëtare zakonore, ndërsa gjykata ndërkombëtare e drejtësisë këtë parim e ka ripohuar në disa raste. Mirëpo, vendet të ndryshme të botës shkeljen e të drejtave të njeriut e justifikojnë nën petkun e sovranitetit shtetëror. Kina si një vend anëtarë i përhershëm në KS-së llogaritet një ndër ta.

Në të shumtën e rasteve kur ky shtet akuzohet për shkeljen e të drejtave të njeriut në Tibet dhe në Xiangjang, zyrtarët kinezë deklarojnë *“Ne besojmë se të drejtat dhe liritë e njeriut janë çështje e sovranitetit”*. (Chengqiu Wu, 2009: 8-15).

Një botëkuptim të tillë mbi korrelacionin e të drejtave të njeriut dhe sovranitetit shtetëror e mban edhe Rusia. (Antonov, 2013:6).

Gjatë aparteidit në Afrikën e Jugut, Bashkësia Ndërkombëtare akuzonte këtë qeveri se në mënyrë sistematike shkel të drejtat e njeriut. Megjithatë, të gjitha këto akuza Afrika e Jugut i cilësoi si ndërhyrje në punë të brendshme.

## ZBEHJA E SOVRANITETIT

Globalizimi solli me vete ndërvarësinë ndërmjet shteteve. Si rrjedhojë e këtij procesi, në skenë do të paraqiten institucione të ndryshme transnacionale. Në këtë formë kuptimi tradicional i sovranitetit shtetëror filloi ta humbte kuptimin që kishte më herët.

Efekti i globalizimit në njëfarë formë dobësoi sovranitetin. Ajo që ndodh në një vend tjetër doemos që të ketë ndikim të gjerë, në këtë mënyrë shtetet nuk mund që të izoloohen.

Arsyetimi i atyre të cilët konsiderojnë se në emër të sovraniteti flijohen të drejtat dhe liritë e njeriut, sot në këtë botë të ndërvarur më nuk qëndron. (Reka, 2010; 215-216). Një aktivitet që u ndërmor pas mbarimi të Luftës së Ftohtë s'do mend se është edhe intervenimi humanitar me qëllim që të mbrohet dinjiteti njerëzor dhe të drejtat e njeriut.

Në debatet rreth intervenimit humanitar u argumentua teza se sistemi uestfalian nuk është më justifikim i përshtatshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare. (Фукүјама, 2005:124). Kur jemi tek kjo çështje, vlen të theksohet se filozofi gjerman Jyrgen Habermas, madje fuqishëm përkrah ndërhyrjen e armatosur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kundër sovranitetit të shtetit.

Intervenimi humanitar është i fokusuar në dy qëllime, edhe atë në:

- a) ofrimin e ndihmës emergjente dhe
- b) ruajtjen e të drejtave fundamentale të njeriut.

Bipolariteti që dominonte politikën globale nga periudha pas LDB-së deri në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, ishte pengesë për intervenimin humanitar dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. (Греј, Коен: 2009:314).

Duke u nis nga ky parim, SHBA-të pas Luftës së Ftohtë konsideronin se për shkaqe të kontekstit politik specifik të KS-së, si dhe mundësisë së vendosjes së mekanizmit të *veto-s* nga anëtarët e saj, aksionet e NATO-s nuk duhet që të varen nga një institucion siç është OKB-ja. (Ружин, 2010:34).

Iniciativa për ndërhyrjen humanitare u paraqit nëpërmjet presionit të hapur të qeverive perëndimore për të ndërmarrë një akt të atillë ndaj vendeve ku dinjiteti njerëzor vendoset në pikëpyetje.

Në vitin 2000, KS-ja e OKB-së përmes miratimit të rezolutës 1296 përcakton se: *“Sulmi ndaj civilëve në konfliktin e armatosur, si dhe refuzimi për vendosjen e ndihmës humanitare tek popullata civile, do të konsiderohet si kërcënim i paqes ndërkombëtare”*.

Cilido qoftë shtet që kërcënon paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, do të duhej t'i nënshtrohet nenit 42 të Kartës së OKB-së, pra, atje ku përmenden forcat ushtarake.

Për këtë, me qëllim që ta ruajë paqen dhe sigurinë, të drejtat e njeriut, Bashkësia ndërkombëtare duhej të hartojë një mekanizëm të atillë, i cili do t'i ruajë vlerat e lartpërmendura. Doktrina e “përgjegjësisë për të mbrojtur” është pikërisht e kësaj natyre.

## PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR

Koncepti “Përgjegjësia për të Mbrojtur” nënkupton t'i mbrosh njerëzit.

Përmes kësaj doktrine e cila është inkorporuar në politikën ndërkombëtare, shteti jo vetëm që ushtron kontroll dhe shtrin sovranitet mbi një territor të dhënë, por edhe ka përgjegjësi për mbrojtjen e qytetarëve të vet.

Megjithatë, nëse ndonjë shtet ose qeveri dështon në mbrojtjen e qytetarëve të saj, që këtu përgjegjësia i kalon komunitetit ndërkombëtar që të përdor metoda diplomatike, humanitare dhe të tjera, me qëllim që të mbrohet popullata civile, si dhe të drejtat e njeriut.

Ideja për një koncept të tillë lindi atëherë kur në vitin 2000 ish sekretari gjeneral i OKB-së Kofi Anan, në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së lëshoi një pyetje sfiduese për komunitetin ndërkombëtar, ndër tjerash ai shtoi: *“Nëse ndërhyrja humanitare*

*është një sulm i papranueshëm mbi sovranitetin, atëherë si duhet të përgjigjemi ndaj shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut...”?!*

Kësaj sfide të shtruar nga Kofi Anan, iu përgjigj qeveria kanadeze përmes formimit të “Komisionit Ndërkombëtar mbi Ndërhyrjen dhe sovranitetin shtetëror” (ICISS).

Në dhjetor të vitit 2001 grupi në këtë komision lëshoi një raport, prej nga edhe u rikonceptualizua “e drejta e intervenimit” si përgjegjësi e mbrojtjes së viktimave të konfliktit. (ICISS, Report, 2001).

Në samitin botëror të vitit 2005, komuniteti ndërkombëtar konfirmoi “Përgjegjësinë për të mbrojtur”, ashtu që shtetet anëtarë të OKB-së në debatet që zhvilluan mbi sigurinë, të drejtat e njeriut, si dhe për reformat në OKB, nënshkruan dokumentin e samitit - *2005 World Summit Outcome*.

Në bazë të këtij dokumenti OKB-ja ka përgjegjësi që të mbrojë popullatën nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, spastrimi etnik dhe krimet e luftës. KS-ja në vitin 2006 përmes rezolutës 1674 riafirmoi përgjegjësinë për të mbrojtur popullatën civile në konfliktin e armatosur. Ky koncept ndërtohet mbi tre shtylla kryesore:

1. Përgjegjësia e çdo shteti që të mbron qytetarët e vet nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, dhe spastrim etnik;
2. Përgjegjësia e komunitetit ndërkombëtar që të inkurajon dhe të ndihmon çdo shtet në kryerjen e kësaj përgjegjësie, si dhe të ndihmon në kapacitete të shtet-ndërtimit;
3. Përgjegjësia e komunitetit ndërkombëtar për veprim kolektiv, në përputhje të plotë me kartën e OKB-së, dhe në bashkëpunim me organizatat regjionale.

Implementimi i këtij koncepti (lexo: përgjegjësisë për të mbrojtur) në praktikë u bë çështje mjaft komplekse tek shtetet anëtarë të OKB-së. Nga tre shtyllat e lartpërmendura, diskutime të shumta u ngritën pikërisht për shtyllën e tretë, në atë se çfarë veprime kolektive duhet të ndërmarr komuniteti ndërkombëtar, kush duhet

të vendos dhe të merr këto veprime dhe cili do të jetë relacioni i konceptit në fjalë me Këshillin e Sigurimit të OKB-së!?

Neni 139 i dokumentit të dalë nga samiti botëror i vitit 2005 precizon se: “*Komuniteti ndërkombëtar përmes OKB-së, ka përgjegjësi që të përdor mjete diplomatike, humanitare dhe mjete tjera paqësore, në përputhje me kapitullin VI dhe VIII të kartës së OKB-së... Ne jemi të përgatitur për të marrë veprime kolektive në mënyrë vendimtare përmes Këshillit të Sigurimit, në përputhje me Kartën përfshirë edhe kapitullin VII-të*”.

Kriza në Libi ishte rasti i parë ku në emër të “Përgjegjesisë për të Mbrojtur” - *nëpërmjet rezolutës 1973 të KS-së* - u realizua intervenimi ushtarak, mirëpo e gjithë kjo, falë mos vendosjes së *veto-s* nga ana e shteteve anëtare.

Edhe pse koncepti në fjalë është një diskurs mjaft idealist, duket se aplikimi i saj në praktikë kryesisht varet nga oreksi i shteteve anëtare të KS-së të OKB-së, gjegjësisht nga (mos) *vetoja* e tyre. Madje, mund të thuhet se “përgjegjësia për të mbrojtur” është peng i shteteve anëtarë të KS-së.

Katastrofa humanitare në Siri më shumë se kurrë kërkon nevojën e zbatimit të këtij koncepti, por sistemi operativ i KS-së pamundëson një gjë të tillë. Aleatët e regjimit sirian të cilët kanë të drejtën e përdorimit *veto-s* në KS, krizën siriane e shohin si çështje të brendshme të Sirisë dhe sovranitetit sirian. Në krizën siriane “përgjegjësia për të mbrojtur” dështoi.

Reformat eventuale brenda për brenda strukturës së OKB-së, përfshirë këtu edhe mënyrën e vendimmarrjes në KS, do të ndihmonin në zbatimin sa më efikas të konceptit në fjalë.

Për Habermasin reformimi i institucioneve ndërkombëtare përfshirë edhe OKB-në, si p.sh. fuqizimi i funksioneve të saja, nevojitet pikërisht për faktin për t’i dhënë mundësi kësaj organizate për të vepruar në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Rishikimi i Kartës së OKB-së ose përfshirjes së “përgjegjesisë për të mbrojtur” brenda kapitujve të kësaj Karte, jo vetëm që do ta

mbante gjallë këtë koncept, por edhe do ta përmirësonte imazhin e OKB-së tek qytetarët e botës.

## CONCLUSION

Human rights are not a matter to be given, they belong to every individual or community. These rights an individual gets since birth. As human rights are present in every country in the world, they are considered as universal.

Respecting human dignity and human rights keeps stable not only a society or country, but all humankind. Their institutionalization in the global level became possible through the establishment of several international organizations.

The UN in this aspect plays an important role, therefore human rights are not to be seen as an internal matter of a state. Thus it should have been, but this is a challenge for several countries of the globe.

These kinds of countries on behalf of the international right, so calling on non-interfering in the internal affairs of a state, human rights are infringed and put human dignity into question. The international community not being able to widen its influence, became a beholder towards these kinds of tragedies, once Ruanda and now Syria, are such an example.

Possible reforms in the organization of UN and its charter would enable as efficient as possible application of different international mechanisms, as “responsibility to protect” in protecting human rights.

Discussions with regard to these reforms in academic circles, governments of different states, and NGO-s would special contributors towards such kinds of initiatives. In absentia of a world government, the credibility of UN would be greater than it is now.

## REFERENCES:

- ANTONOV, M. (2013). *“The philosophy of sovereignty, human rights, and democracy in Russia”*, St. Petersburg: National Research University Higher School of Economics.
- COX, M. SHAWKI, N. (2009). *“Negotiating Sovereignty and Human Rights: Actors and Issues in Contemporary Human Rights Politics”*, Cornwall: Ashgate Publishing Company.
- ELEZI, Z. (2008). *“Të drejtat e Njeriut dhe Roli i Shërbimeve Publike”*, Tetovë: Universiteti EJL.
- FREEMAN, M. (2011). *“Human Rights: An Interdisciplinary Approach”*, Malden: Polity Press.
- GOLDSTEIN, J. (2001). *“Marrëdhëniet Ndërkombëtare”*-Tiranë: Dituria.
- KRASNER, D. S. (2001). *“Problematic Sovereignty: Contested Rules and Political Possibilities”*, New York: Columbia University Press.
- MERTUS, J. (2009). *“The United Nations and Human Rights: A guide for a new era”*, New York: Taylor & Francis.
- MIRBAGHERI, F. (2000). *“Conflicting Interests: The United Nations versus Sovereign Statehood”* Cyprus: Global Dialogue.
- OREND, B. (2002). *“Human Rights: Concept and Context”*, Mississauga: Broadview Press.
- POLLIS, A. SCHWAB, P. (2000). *“Human Rights: New Perspectives, New Realities”*, London: Lynne Rienner Publishers.
- REKA, B. (2010). *“Gjeopolitika dhe teknikat e Zgjerimit te UE-së”*, Bruksel: ASPECT.
- SWEET, W. (2003). *“Philosophical Theory and the Universal Declaration of Human Rights”*, Ottawa: University of Ottawa Press.
- STUMPF, E. S. (2000). *“Filozofia historia & problemet”*, Tiranë: Toena.
- VERDIRAME, G. (2011). *“The UN and Human Rights: Who Guards the Guardians?”*, Cambridge: Cambridge University press.

• WU, Ch. (2009). *“Sovereignty, Human Rights, and Responsibility: Changes in China’s Response to International Humanitarian Crises”*. Fudan University.

• БЕЈЛИС, Ц. ВИРЦ, Ц. ГРЕЈ, К. КОЕН, Е. (2009). *“Стратегија Во современиот Свет”*, Скопје: Nampres.

• ФУКУЈАМА, Ф. (2005). *“Градење на Држава, Управувањето и светскиот Поредок во 21 век”*, Скопје: Slovo.

• РУЖИН, Н. (2010). *“НАТО ВО СОВРЕМЕНИТЕ МЕЃУНАРОДНИ ОДНОСИ”* Скопје: FRIEDRICH EBERT STIFTUNG.

• CHARTER OF THE UNITED NATIONS AND STATUTE OF THE INTERNATIONAL COURT OF JUSTICE. (1945). San Francisco.

• REPORT OF THE INTERNATIONAL COMMISSION ON INTERVENTION AND STATE SOVEREIGNTY. (2001). *“The responsibility To Protect”*, Ottawa: International Development Research Centre.

#### UNITED NATIONS RESOLUTIONS:

• United Nations, Security Council, 4011th Meeting, NY, June, 1999.

• United Nations, Security Council, Resolution 1296, NY, April, 2000.

• United Nations, General Assembly, “2005 World Summit Outcome”, Sixtieth session, NY, October, 2005.

• United Nations, Security Council, Resolution 1674, NY, April, 2006.